



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.03-159

11.04.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe lidhur me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, neni 19 i Rregullores për mbrojtjen e të miturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 172/14), pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1175/1 datë 16.3.2023 dhe Konkluzioni ark.nr. 02-1777/4 datë 4.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 13- të mbajtur më 10.4.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, për shkelje të kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe të nenit 19 të Rregullores për Mbrojtjen e të miturve (RRPMM), në atë mënyrë që në shërbimin programor televiziv, të transmetuar më 1 mars 2023, filmi artistik "Lufta ka përfunduar (The War Is Over)" është transmetuar pa sinjalizimin e duhur paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes .

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1175/1 datë 16.3.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

2. Urdhërohet Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRPMM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si dita e miratimit të tij konsiderohet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga ligji i përmendur, lejet, vërtetimet e dhëna (lëshuara) për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka cenim ose

shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të ligjit, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimit mediatik audiovizuel nuk duhet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, psiqik dhe moral të personave të mitur, veçanërisht programet që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme. Ndalea nga paragrafi (1) i këtij neni referohet gjithashtu dhe për programet e tjera që do të mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, psiqik dhe moral të personave të mitur, përveç kur ofrohen me transmetimin e tyre ose përsëritje në periudha të caktuara kohore dhe/ose me aplikacion të një mase të caktuar, ku personat e mitur në periudhën e transmetimit ose ritransmetimit nuk do të mund t'i dëgjojnë ose t'i shikojnë këto programe. Kur programe të tilla transmetohen ose ritransmetohen në forma të pakoduara, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizuel është i detyruar para transmetimit të tyre të ofron më parë në mënyrë akustike paralajmërim dhe mundësi për tu identifikuar me ndihmën e shenjave vizuale gjatë kohëzgjatjes së tyre (neni 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV).

Në nenin 19 të RRPMM përcakton se sinjalizimi paraprak detyrimisht aplikohet para fillimit dhe gjatë kohës së transmetimit të programeve të shërbimit programor televiziv dhe në vendin përkatës pranë programeve të disponueshme në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, dhe atë: në të gjitha programet e transmetuara artistike dhe në lloje të programeve me funksion informativ, edukativ dhe argëtues, qoftë në tërësi ose përmes pjesëve të tyre, ata munden të ndikojnë negativisht (dëmshëm) mbi personat e mitur.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 16 mars 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, transmetuar më 1 mars 2023, në nivel shtetëror, nga ku u konstatua shkelje e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neni 19 i RRPMM.

Gjegjësisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore, është konstatuar se në kundërshtim me nenin 19 të RRPMM (sinjalizimi paralajmërues), në shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, transmetuar më 1.3.2023, pa sinjalizim paralajmërues të detyrueshëm dhe pa shenjë të përshtatshme të klasifikimit, është transmetuar filmi artistik "Lufta ka përfunduar (The War Is Over)".

Shkelja nga pika 1 i këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1175/1 datë 16.3.2023, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, më 17.3. 2023, dërgoi Shkresë Nr.ynë ark.10-1175/2 datë 17.3. 2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1175 /1 datë 16.3.2023, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV dhe nga RRPMM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 20.3.2023. Në afatin e paraparë, Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRPMM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.4.2023, pasi shqyrtoi Raport me shkrim dhe konkludoi ndaj Shoqërisë Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, t'i shqiptohet masë - vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) të Ligjit të njëjtë dhe nenit 19 të RRPMM, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1175/1 datë 16.3.2023 dhe Konkluzioni ark.nr. 02-1777/4 datë 10.4.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV dhe RRPMM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 10.04.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet Shoqëria Radiodifuzive NASHA TV SHPKNJP Shkup, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RRPMM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit. Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr. 10- 1175/1 datë 16.3.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.